



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.964/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Burim Ademi kryesues, Zyhdi Haziri dhe Mymete Kicaj anëtar, duke vendosur përkitazi me apelin e kandidates për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Zubin Potokut, Liridona (Ramadan) Kahrmani, nga Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Prishtinë-dega në Zubin Potok, paraqitur kundër vendimit me numër 2948-2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal, në seancën e panelit të mbajtur më datë 07.11.2021, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet i pabazuar apeli Anr.964/2021 i datës 04.11.2021, i kandidates për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Zubin Potokut, Liridona Kahrmani, nga Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Prishtinë-dega në Zubin Potok, paraqitur kundër vendimit me numër 2948-2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal, me të cilën ka kërkuar që të radhitet në listën e kandidatëve për kuvend Komunal në bazë të kuotës gjinore.

A r s y e t i m

PZAP-i, me datë 04.11.2021, ka pranuar apelin Anr.964/2021, i ushtruar nga Liridona Kahrmani, për Kuvend Komunal, nga Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje, me të cilën ka pretenduar se tek shpërndarja e ulseve në Kuvendin Komunal të Zubin Potokut tek gjinia pakicë, është shkelur neni 8 paragrafi 8.4 i Ligjit nr.03/L-72.

PZAP-i, pas shqyrtimit të apelit, vlerësimit të pretendimeve ankimore, dhe në kuptim të nenit 105 paragrafi 1, dhe nenit 117 paragrafët 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është i pa bazuar

Nga shkresat e lëndës, rezulton fakti se, Kandidatja për Kuvend Komunal nga Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje, Liridona Kahrmani, kërkon që ulësja e fundit që është e mbushur me gjinin mashkull të zëvendësohet me gjinin femer. Paneli pas shqyrtimit të apelit erdhi në

përfundim se apeli i ushtruar nga Liridona Kahrimani, Kandidate për Kuvend Komunal nga Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje është i pa bazuar.

Paneli, vlerëson se parashtruesja e apelit në mbështetje të pretendimeve të saj, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse lidhur me shkeljet e pretenduara nga nenit 8 paragrafi 4 të Ligjit nr.03/L-72, pasi që në rastin konkret, në listën ku ka kandiduar apeluësja në listën e të përzgjedhurve për Kuvend Komunal në Komunën e Zubin Potokut është radhitur vetëm bartësi i listës, që rezulton fakti se pretendimi i kandidates së lartcekur është i pa bazuar, sepse në këto raste kur kemi vetëm bartësin e listës si kandidat që fiton ulëse në Kuvend Komunal nuk vjen në shprehje kuota gjinore. Parashtruesja e apelit nuk ka ofruar fakte dhe prova bindëse, edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në rastin konkret, paneli, nuk mundi të konstatoj se ka pasur diskriminim gjinorë, ashtu siç pretendon ankuesi, për faktin se thëniet e saj nuk mbështetën në asnjë provë konkrete dhe të njëjtat janë vetëm pretendime dhe nuk argumentohen me asnjë provë.

Andaj, Paneli vlerësoi se apeli i parashtruar, nuk është bazuar në dëshmi të qarta dhe bindëse ashtu siç përcaktohet në nenin 117 par.3, të LZP-së, pasi që nga shkresat e lëndës nuk mund të vërtetohet se ka ndodhur ndonjë shkelje e ligjit nr.03/L-72, saktësisht nenit 8 paragrafi 4.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të neneve 115 paragrafi 1, 117 dhe 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr.964/2021 më datën 07.11.2021



Kryesues i Panelit
Burim Ademi

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par.4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimimit të këtij vendimi.